



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM PËR SHYTP

Rasti: Rasti i përfimit të kontrollit të shoqërisë Loom Technologies GmbH nga shoqëria TB Digital Services GmbH.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.370 prot., i AK, datë 09.08.2021 “Njoftimin e përqendrimit të transaksionit TBDS-LOOM”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me përfimin e kontrollit të vetëm të shoqërinë Loom Technologies GmbH nga shoqëria TB Digital Services GmbH

Referuar dokumentacionit, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: TB Digital Services GmbH , është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman me objekt aktiviteti: Sigurimi kryesisht dixhital i lëvizshmërisë, shërbimeve të logjistikës dhe transportit të të gjitha llojeve, prodhimi dhe shitja e produkteve të ndërlidhura, si dhe pjesëmarrja në kom pani të tjera., etj.

TB Digital Services GmbH kontrollohet në mënyrë indirekte nga Traton SE, aktiviteti i të cilës është biznesi i kamionëve dhe autobusëve i Grupit Volkswagen. Grupi Volkswagen drejtohet nga ndërmarrja mëmë Volkswagen Aktiengesellschaft (Volkswagen AG), e cila operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

Pala shitëse :

1. ProAktiv GmbH & Co. KG , është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman e cila ka një partner me përgjegjësi personale dhe përfaqësohet individualisht. Shoqëria ProAktiv GmbH & Co. KG, është aksionere në shoqërinë Loom Technologies GmbH.

2. Aksionarë (5 individë), të cilët zotërojnë aksione në shoqërinë Loom Technologies GmbH.

Target: Loom Technologies GmbH , është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: Zhvillimi dhe konsulenca mbi softuerët.

Shoqëria Loom Technologies GmbH, nuk zotëron degë qpo filial në Shqipëri dhe nuk realizon të ardhura.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, sipas të

cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.